

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Për: Komuna e Mamushës**

**Për Aktivitetin e Prokurimit:**

<b>Nr i prokurimit</b>	<b>626-24-5702-1-2-1</b>
<b>Nr i brendshëm</b>	<b>626-24-011-1-2-1</b>

Sa i përket tenderit për: **“FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE”**.

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**N.T.P. "Gresa - Commerc"**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Piranë**

*(Adresa)*

**Prizren**

*(Vendi)*

**20 000**

*(Kodi postar)*

**044 611 761**

*(Numri Telefonit)*

**N/A**

*(Numri i Faks-it)*

**Sahit Bajrami**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**nptgc1@hotmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**26.07.2024**

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*



## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 10.06.2024  
Hapja e ofertave: 01.07.2024  
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 23.07.2024

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për

*Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**  
**Neni 6 i LPP-së**  
**Neni 7 i LPP-së**  
**Neni 59 i LPP-së**  
**Neni 60 i LPP-së**  
**Neni 69 i LPP-së**  
**Neni 72 i LPP-së.**

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Ne me dt.23.07.2024 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë grupin e OE "**BERVENIKU CORPORATION**" SH.P.K. & AVNI MURTEZI B.I., ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

*Në dosje të tenderit në nenin 5.5 dhe Njoftimin për Kontratë në III.1.3) është kërkuar që:*

*-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin e liferimit.*

*-Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e porosisë.*

*Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.*

*Ju nuk e keni ofruar afatin e liferimit sikur është kërkuar më lartë.*

***Lëshimi i cekura më lartë ka bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.***

Ju sqarojmë se arsyeja për eliminimin tonë është e paqëndrueshme për faktin se kërkesa në lidhje me afatin e liferimit në këtë fazë është e panevojshme. Afati i liferimit përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra OE në momentin e nënshkrimit të kontratës e pranon edhe afatin e liferimit të cilin e përcakton autoriteti kontraktues, andaj në këtë rast ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi më këtë arsye të eliminimit.

Gjithashtu në rast se autoriteti kontraktues ka pasur dilema në lidhje me çështjen e afatit të liferimit, atëherë e njëjta ka mundur të kërkojë sqarime shtesë dhe ne do të kishim sqaruar dhe deklaruar që afati i liferimit është 15 ditë ashtu siç është përcaktuar në dosje të tenderit.

Në këtë rast mos prezantimi i deklaratës për afatin e liferimit duhet të cilësohet si devijim i vogël sipas dispozitave të nenit 59.4 të LPP-së ku është specifikuar " 4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është

*në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.*

Pra përderisa deklarata për afatin e liferimit nuk përbën ndonjë ndryshim material dhe kur kemi parasysh faktin se në këtë aktivitet të prokurimit ne kemi ofertuar me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë për 13,765.00 euro, atëherë mos prezantimi i deklaratës për afat të liferimit duhet të konsiderohet si devijim i vogël.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”,* mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që është rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të nxjerr:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit të OE **N.T.P. "Gresa - Commerc** si dhe të **ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në

**RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, në vlerë prej 5,000.00 euro.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*